

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Kompani e Sigurimeve “[B...]” Basel, të cilin e përfaqëson “[I...]” L.L.C. nga Prishtina, - “[B.N]”, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “[K...]”, me seli në Prishtinë, për shkak të regresit, në shumën prej 6,285.16 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, III.EK.nr.137/15, të datës 09.02.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.01.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEȚ si e pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “[K...]”, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Ekonomike, III.EK.nr.137/15, të datës 09.02.2017, **VËRTETOHEȚ**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Kompania e Sigurimeve “[B...]” Basel. Ndërsa në piken I të dispozitivit te aktgjykimit është detyruar e paditura Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”, me seli në Prishtinë, që paditësit Kompani e Sigurimeve “[B...]” Basel, t’ia paguajë në emër të shpërblimit të dëmit, shumën e përgjithshme prej 6,285.16 €, me kamte ligjore prej 12%, duke llogaritur nga data 04.12.2013, e deri në pagesën definitve , të gjitha këto në afatin parativ prej 7 ditësh , duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim. Në Paragrafin II të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit t’ia kompensoje dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë e përgjithshme prej 1,867.00€, në afatin kohor prej 7 ditësh nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”, me seli në Prishtinë, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar të se drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoje ankesën e te paditurës “[K...]” dhe ta refuzoje ne tërësi kërkesëpadinë e paditësit si te pabazuar apo aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje Ekonomike III.EK.nr.137/15 të datës 09.02.2017 ta prishë dhe lëndën t’ia kthejë në rivendosje dhe rigjykim Gjykatës së shkallës së pare.

Paditësi në përgjigje në ankesë ka propozuar që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pabazuar dhe te vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Prishtinë –Departamenti për çështje ekonomike III.EK.nr.137/15 të datës 09.02.2017.

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, Kompani e Sigurimeve "[B...]" Basel, me datë 20.03.2015, ka parashtruar padi regresi, kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve "Kosova e Re", me seli në Prishtinë për shpërblimin e dëmit-kasko regres të pësuar nga aksidenti i komunikacionit me datën 14.07.2013 për qka ka kërkuar nga gjykata t'ia paguaje shumën e përgjithshme prej 9,546. 79€ , me kamatë ligjore prej 12 % duke filluar nga data 04.12.2013, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore kundër te paditurës Kompania e Sigurimeve "Kosova e Re" me seli në Prishtinë.

Gjykata e shkalles së pare nga provat e administruara ka konstatuar se me datën 14.07.2017, , ka ndodhur aksidenti i trafikut, i cili është shkaktuar më fajin eksluziv të siguruarit të së paditurës "[E.M]" ngasës i automjetit Audi me targa "[...]", pronë e "[XH.M]", i siguruar tek e paditura. Gjykata e shkalles së pare me anë të ekspertizës se makinerisë për vlerësimin e dëmit nga eksperti "[S.B]" si dhe sqarimeve shtese në seancën e datës 24.01.2017, ka vërtetuar faktin se automjeti i udhëtareve SAAB, ka pësuar dëmtime të mesëm materiale në pjesën e përparme ballore ana e majtë. Eksperti ka theksuar se pasi që automjeti është riparuar në Zvicër vlera e dëmit duhet të merret nga vlerësimi i siguruesit kasko, vlera e përgjithshme pa tvsh arrin shumën prej 6,764.00 CHF. Gjykata e shkalles së pare i besoi plotësisht konstatimit te ekspertit të makinerisë pasi që i njëjti përcaktimin e lartësisë së dëmit e kishte bërë duke marrë për bazë shkresat te cilat gjinden në lëndë dhe në bazë të këtij dokumentacioni për vlerësimin e çmimeve të pjesëve të riparimit dhe orëve të punës ka aplikuar çmimet e tregut në Zvicër.

Gjykata e shkalles së pare ka konstatuar se paditësi ka bërë kompensimin e dëmit ne shumën prej 6,764.00 CHF, andaj në baze te kursit valutor të XE Currency Convertet, të datës 24.01.2017, ka konstatuar se në të njëjtën datë 1 CHF, ka qenë e barasvlershme me 0.93€, që do te thotë, që shuma e paguar prej 6,764.00 CHF, është e barasvlershme me 6,285.16 €.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsy se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nen 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkalles së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 939 par.1 të LMD-së, me të cilin është përcaktuar se "me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin, në bazë të vetë ligjit, deri në shumën e

kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e të siguruarit ndaj personit i cili mbi cilën bazë qoftë është përgjegjës për dëmi". Në rastin konkret nga shkresat e lëndës dhe nga Aktvendimi i Gjykates Themlore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Kundërvajtje, me Nr. Regj.K.IV. 9957/2013, dt.16.07.2013, rezulton se përgjegjës për dëmin e shkaktuar në aksidentin

e datës 14.07.2013, ka qenë i siguruari i të paditurës, me ç'rast paditësi ia ka paguar të siguruarit të tij kompensimin e dëmit të pësuar dhe me pagimin e kompensimit të gjitha të drejtat e të siguruarit kanë kaluar të paditësi.

Gjykata e Apelit i shqyrtoj pretendimet ankimore të paditurës në lidhje me llogaritjen e vlerës së dëmit jashtë të çmimeve të tregut, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara për arsyen nga dispozitat e nenit 8 paragrafi 2 pika g të BQK-së i cili përcakton se: “*dëmi në mjetin motorrik të dëmtuar me targa të huaja mund të pranohet në bazë të faturës së riparimit të bërë në vendin e regjistrimit të mjetit motorrik duke bërë krahasimin e atij riparimi me procesverbalin mbi dëmin*”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vlerë reale të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga i siguruari i të paditurës, lartësia e të cilët është vërtetuar me ekspertizën e ekspertit Nexhmi Shala, me të cilën janë konstatime të mbështetura në prova që gjenden në shkresat e lëndës, nga çka rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka pranuar çmimet e llogaritura sipas çmimeve të tregut në Zvicër, të cilat në tërësi i pranon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet ankimore lidhur me mbulesën territoriale të sigurimit të polisës së të dëmtuarit të paditësi si dhe me pagesën e shumës prej 1,100.00 €, por gjeti se gjykata e shkallës së parë i ka trajtuar drejtë këto çështje dhe ka dhënë sqarimet te detajuar dhe të plota në arsyetimin e aktgjykimit, e me të cilat pajtohet plotësisht edhe kjo gjykatë.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të së paditurës, lidhur me lartësinë e normës së kamates, por gjeti se të njëjtat janë ta pabazuara, ngase neni 26, pika 6, i Ligjit mbi Sigurimin e Detyruar nga Auto përgjegjësia, përcakton lartësinë e kamates prej 12% nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ia ka njojur kamaten nga data e parashtrimit të kërkesës te e paditura, datë 04.12.2013, andaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërthënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsyen të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,
Ae.nr. Ae.nr 97/2017, dt. 18.01.2019

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutulli, d.v.

